

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria e para në rajon për testin PISA, Rama krenar për nxënësit, mësuesit e ministrinë: Dëftesë e ja shtëzakonshme për ne
ADRESA	https://newsbomb.al/politike/shqiperia-e-para-ne-rajon-per-testin-pisa-rama-krenar-per-n-xenesit-mesu-i400755
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 06:51:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 06:48:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	44550e0b24ebab6372703d409269f69945ebc127ad622fcaab8ed0991ca9f2d8
TEKSTI	e583a29af54fd6f0bbb752c260ce1fdf72bf463abf5a9111b9f4a9b5e796ab72
PAMJA	fd90cd5e37020981cdd9b940d58612e9281462390a8ab18119ce4111bc5687d1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e1de04c15b9d576f97c96443b325acefd234c591a0a2968e0d1bcfb8c92ac344
E MËPARSHMJA	7c99652cb8b741213b2f731dca607c7585b8b532e2862e48df11cc191e929f89
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e1de04c15b9d576f97c96443b325acefd234c591a0a2968e0d1bcfb8c92ac344>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



12 numrat e parë FALAS!

[Version PDF](#)

[Abonohu te Revista](#)



- [Kreu](#)
- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)
- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)



Created and monetized by  mediadesk



Çështjet kryesore

Live Updates

[Arrestohet Ergys Agasi](#)

E Enjte 10:25

Live Updates

["Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!](#)

E Hënë 09:32

Live Updates

[SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjijkës](#)

E Martë 14:24

[Politikë](#) 9 Shtator 2026, 08:48

Shqipëria e para në rajon për testin PISA, Rama krenar për nxënësit, mësuesit e ministrinë: Dëftesë e jashtëzakonshme për ne

Shkruar nga Newsbomb



 Shqipëria e para në rajon për testin PISA, Rama krenar për **Edi Rama**

Kryeministri Edi Rama mëngjesin e sotëm ka reaguar në lidhje me rezultatet shumë të mira të shqipërisë në testin ndërkombëtar PISA 2025. Kreu i qeverisë e ka cilësuar këtë rezultat si një “dëftesë të jashtëzakonshme” për vendin tonë.

“Ka ditë që shkohet në punë me ndjesinë që kjo është detyra dhe ka ditë që shkohet në punë me kënaqësi të madhe, po shumë të madhe. Dje kemi marrë një rezultat, një dëftesë, për të cilën kemi ounuar shumë fortë, jo në e dy ditë por kemi ounuar shumë fortë për në vit të tërë për të adresuar realisht aty ku duhej të gjitha pikat e nevojshme. Shqipëria dje ka marrë një dëftesë të jashtëzakonshme sepse është një dëftesë që i takon atyre që janë drita e syve, të prindërve të këtij vendi, nxënësve tanë.”, është shprehur Rama.

Përmes një transmetimi “live” në “Facebook”, rama vlerësoi artijt e nxënësve duke thënë se tashmë Shqipëria renditet e para në rajon. Rama u shpreh se ky rezultat është një vlerësim jo vetëm për qeverinë dhe Ministrinë e Arsimit, por edhe për mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe nxënësit.

“Mirëmëngjesi! Ka ditë që shkohet në punë me ndjesinë që kjo është detyra. Ka ditë që shkohet në punë me ndonjë mendim që e përcakton atë ditë si rezultat i një çështjeje që është në tryezë dhe ka ditë si kjo që shkohet në punë me një kënaqësi shumë të madhe, por shumë të madhe. Sepse dje kemi marrë një rezultat, një dëftesë për të cilën kemi punuar shumë fort dhe jo një e dy ditë, po kemi punuar shumë fort për një vit të tërë për të adresuar realisht aty ku duhej të gjitha pikat e nevojshme.

Shqipëria dje ka marrë një dëftesë të jashtëzakonshme, sepse është një dëftesë që i takon atyre që janë drita e syve të prindërve të këtij vendi, nxënësve tanë. Kemi dalë si asnjëherë më mirë në testin PISA 2025, një test i cili përcakton nivelin e të nxënët për fëmijët e arsimit parauniversitar në matematikë, shkencë dhe lexim. Dhe jo vetëm kemi bërë një përparim të jashtëzakonshëm pas atij momenti çoroditjeje që shkaktoi Covidi, edhe ku të gjitha vendet në fakt ranë dhe ne patëm një rënie të ndjeshme, e cila, si të thuash, na dha një shuplakë pas një periudhe të mëparshme rritjeje të butë, por konstante dhe sot jemi faktikisht të parët në rajon. Të parët në rajon, duke zënë vendin që kemi ambicie të zëmë në çdo drejtim dhe në çdo sektor, por që në këtë rast i bën një nder shumë të madh, një nder shumë të madh jo qeverisë thjesht, por i bën një nder shumë të madh në radhë të parë të gjithë atyre që kanë në duar fëmijët tanë.

I bën një nder shumë të madh edhe drejtuesve të shkollave, natyrisht gjithmonë pas mësuesve. Kemi bërë një punë kolosale milingonash me drejtuesit e shkollave. Shkolla e drejtorëve është një histori e qartë suksesi, i bën një nder shumë të madh patjetër edhe vendit si i tillë, sepse krijon një lehtësi psikologjike edhe për prindërit.

Prindërit e mbytur nga balta, prindërit e mbytur nga jargët e gjithfarë lloj vemjesh në kanalet sociale, që nuk lënë orë e minutë pa jashtënxjerrë helm për çdo gjë në këtë vend dhe që natyrisht ngarkojnë psikologjikisht gjithë popullatën.

Është një rezultat fantastik edhe është një rezultat inkurajues, i jashtëzakonshëm. Është një rezultat që flet për punën shumë të mirë të bërë edhe nga Ministria e Arsimit, për punën e bërë nga ministrat e arsimit njëri pas tjetrit dhe ndjehem jashtëzakonisht mirë. Është një histori koti, thotë kjo Eda Merkula. Një histori koti. Një histori koti që Shqipëria del e para në rajon në një test të së ardhmes, në testin për dijet e fëmijëve tanë në shkencë, në matematikë dhe në lexim. Një histori koti.

Ajo është merita e atyre nxënësve, thotë kjo tjetra, që e kanë marrë vetë rezultatën. Në fakt, jo. Në fakt, jo. Nxënësit kanë pasur historikisht mes tyre ata më të mirët, ata më të dhënit, por sikur të ichte meritë thiesht dhe vetëm e tyre nuk do të ndryshonin rezultate. Do ichte gjithmonë në ashti

Çfarë ke bërë për Shqipërinë, thotë, ke 12 vjet? Urdhëro. Po flas sot, tani për një rezultat fantastik. Një nga ato rezultate që ndërtohen vit pas viti, muaj pas muaji, javë pas javë, ditë pas dite, që nuk bëjnë lajm, që nuk bëjnë zhurmë, që nuk krijojnë kushtet për të ngacmuar vëmendjen tënde në rrjetet sociale bashkë me Fatmirin. Bashkë me Fatmirin që thotë: je bërë qesharak. Patjetër, patjetër. Është shumë qesharake kjo që po them, që Shqipëria ka dalë e para në testin më të rëndësishëm për fëmijët tanë, për nxënësit tanë, testin PISA 2025. E para në rajon. Dakord? Se ne matemi me rajonin në radhë të parë dhe pastaj me të tjerët. Ndërkohë që po ju them dhe tjetrën, që jo vetëm kemi bërë një kërcim të jashtëzakonshëm pikësh, por kemi gjithashtu lënë pas edhe disa vende, disa vende që sot janë në Bashkimin Europian.

Dëgjove, Fatmir, se ti qenke insitues në atë marrëzinë tënde. Si po gënjej unë, çfarë po gënjej? Unë po them një të vërtetë që është thënë botërisht dhe në shpalljen e rezultateve dhe ti mund të hysh edhe t'i verifikosh, por ti nuk je i interesuar për këtë. Unë e di, edhe s'ke pse je interesuar, sepse ti je i zhytur në helmin e kanaleve sociale dhe më vjen shumë keq. Më vjen shumë keq për ty.

Ndërkohë që më vjen shumë mirë për të gjithë mësuesit, më vjen shumë mirë për të gjithë drejtuesit e shkollave, më vjen jashtëzakonisht mirë për prindërit që tanimë kanë një arsye të marrin frymë lirisht pas gjithë torturës që heqin në këto kanalet sociale, ku çfarë nuk dëgjojnë e çfarë nuk shohin e çfarë nuk u thuhet për fatin e fëmijëve në këtë vend, i cili më të mirën e ka vetëm përpara dhe i cili është një vend që përparon çdo ditë, duan s'duan ata që s'duan. Tani mbërrita, vazhdojmë punën.”, tha Rama.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu

Politikë

[Mazniku SQARON propozimin për shkrirjen e bashkive: Nuk preken shërbimet ndaj qytetarëve! Ndryshojnë vetëm disa zyra](#)

E Martë 22:26 Newsbomb

Politikë

[Ia cilësuan deputeten hajdute dhe e filmuan duke i zënë pritë, Rama për incidentin e Luarasit: Mjerim mendor](#)

E Martë 21:49

Politikë

[E “zunë mat” dhe e cilësuan hajdute, Luarasi nuk toleron: Vajzat do të përballen me drejtësinë! Poshtërimi nuk është aktivizëm \(VIDEO-MESAZHI\)](#)

E Martë 19:48 Newsbomb

Politikë

[Qytetarët i “zunë pritë” Luarasit para seancës plenare, Albana Koçi denon aktin: Kjo nuk është protestë, është DHUNË e shëmtuar](#)

E Martë 18:35

Politikë

["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE: Brenda 2030, synojmë të ngremë flamurin kuqezi në Bruksel](#)

E Martë 17:47

Politikë

[FOTO-LAJM/ Njoftoi një ditë me dinamika! Marjana Koçeku bën hapin e radhës në Kuvend, liron karrigen te socialistët, zhvendoset pas demokratëve](#)

E Martë 17:43 Newsbomb

Politikë

[U takua për herë të parë me Ramën pas emërimit, mesazhi i Ambasadores së BE-së: Tani, koha për punë](#)

E Martë 17:39

Politikë

[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet për të goditur njëri-tjetrin](#)

E Martë 17:35

Politikë

[Peleshi hap seancën plenare me premtime: Do punojmë fort për anëtarësimin në BE! Reforma territoriale synon të na afrojë me qytetarët](#)

E Martë 17:22 Newsbomb

Politikë

[Kuvendi nis zyrtarisht sesionin e ri, protestuesit mblidhen jashtë dhe presin deputetët, Policia bëhet gardh](#)

E Martë 17:21

Politikë

[21 miliardë lekë për projektin e ri të sheshit "Nënë Tereza", FOTOT: Restorante, parkim nëntokë dhe një muze në -19 metra! Makinat do kalojnë në tunele](#)

E Martë 16:51

Politikë

["Hajduta! Ikni futuni atje tani!" Qytetarët "kapin mat" Luarasin, deputetja socialiste injoron protestuesit: Sa turp! \(VIDEO\)](#)

E Martë 17:04 Newsbomb

Politikë

[Ish-ministre e Arsimit, ja kush është nënkryetarja e re e Parlamentit](#)

E Martë 16:56

Politikë

["SPAK nuk po bën detyrën, të ngrihet menjëherë Komision Hetimor", Belind Këllici kërkon që deputetët të votojnë sot për akuzat e Ahmetaj](#)

E Martë 16:19

Politikë

[Shqipëria pjesë e Forcës Ndërkombëtare për Gazën, ministri Hoxha pret Gjeneralin Jasper Jeffers: Të vendosur krah Amerikës për paqe dhe siguri](#)

E Martë 15:16

Politikë

[Nisja e sesionit të ri parlamentar, Begaj mesazh deputetëve dhe iu kujton protestën qytetare: Tregon që demokracia po zhvillohet në Shqipëri](#)

E Martë 15:10

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit

Foto e Ditës

[Shqipëria lë pas rajonin në PISA 2025!](#)

E Mërkurë 09:15

Aktualitet

[FOTOT/ Rrënoja dhe shkatërrim, çfarë la pas shpërthimi i fuqishëm i karburantit "Eida" te Brryli](#)

E Mërkurë 08:58

[Zbulo më shumë artikuj >](#)

Hapësire reklamuese

bombvideo

[Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube](#)



["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE](#)



[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet](#)



[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"](#)



[E pazakontë tek "Mbretëresha Geraldinë", vjen në jetë në lindje me natyrë djali me peshë 5.1 kg](#)



[Goditet grupi i drogës në Sarandë, 20 persona të prangosur, shpërndanin lëndën narkotike](#)



[U zhvatën 100 mijë euro qytetarëve duke i mashtruar, 27-vjeçarja me një tjetër grua i gënjenin se...](#)

op
ed

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor](#)

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë](#)

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse “Jo”-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë](#)

E Diel 18:33



-
-
-
-

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtore i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

[Abonohu te Revista](#)

Created and monetized by  **mediadesk**

- [Politikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kulturë & Art](#)
- [Rajon](#)

- [Sport](#)
- [Bota](#)
- [Teknologji](#)
- [Showbiz](#)
- [SocialBomb](#)

Merr lajme me email

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Created and monetized by  **mediadesk**